<p>4. Vendimi i Kuvendit të Komunës për themelimin e komisionit vlerësues duhet të përmbajë detyrat, përgjegjësitë dhe çështjet tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për punën e komisionit vlerësues.</p> <p>5. Administrata e komunës ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.</p> <p>6. Për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës formohet komision vlerësues.</p>	<p>4. The decision of the Municipal Assembly for establishing the Evaluation Commission shall contain duties, responsibilities and other issues considered as important for the work of the Evaluation Commission.</p> <p>5. The Municipal Administration shall provide support to the Evaluation Commission for allocation for use of immovable property of the municipality.</p> <p>6. An Evaluation Commission shall be established for each preliminary decision of the Municipal Assembly.</p>	<p>4. Odluka skupštine opštine o osnivanju Komisije za procenu treba da sadrži zadatke, odgovornosti i druga pitanja koja se smatraju važnim za rad Komisije za procenu.</p> <p>5. Opštinska administracija pruža podršku Komisiji za procenu davanja na korišćenje opštinske nepokretne imovine.</p> <p>6. Za svaku preliminarnu odluku Skupštine opštine formira se Komisija za procenu.</p>
<p>Neni 18 Komisioni i ankesave</p>	<p>Article 18 Appeal Commission</p>	<p>Član 18 Komisija za žalbe</p>
<p>1. Kuvendi i Komunës formon Komisionin e Ankesave i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve.</p> <p>2. Kryetari i Komunës i propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve të ndryshme politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar, i cili propozohet nga sektori jo qeveritar lokal.</p>	<p>1. Municipal Assembly shall establish the Appeal Commission, which shall review the appeals of parties in the procedure for allocation of short-term and long-term use of immovable property of the municipality, which shall be composed of five (5) members.</p> <p>2. The Mayor shall nominate two (2) members from the municipal executive, the Municipal Assembly proposes two (2) members of the Municipal Assembly from the ranks of various political entities and one (1) member from the non-governmental sector, which is proposed by the local non-governmental sector.</p>	<p>1. Skupština opštine formira Komisiju za žalbe koja će razmatrati žalbe strana u proceduri davanja na kratkoročno i dugoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine, koja se sastoji od pet (5) članova.</p> <p>2. Gradonačelnik opštine predlaže dva (2) člana i izvršne vlasti opštine, Skupština opštine predlaže dva (2) člana iz Skupštine opštine iz redova različitih političkih subjekata i jednog (1) člana iz nevladinog sektora, kojeg predlaže lokalni nevladini sektor.</p>

<p>3. Vendimi për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të komisionit aprovet në Kuvendin e Komunës me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë.</p> <p>4. Vendimi i Kuvendit të Komunës për themelimin e komisionit të ankesave duhet të përmbajë detyrat, përgjegjësitë dhe çështjet tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për punën e komisionit të ankesave.</p> <p>5. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit të ankesave sipas kërkesës së tyre.</p> <p>6. Mandati i komisionit të ankesave është dy (2) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.</p>	<p>3. The decision on the nomination and dismissal of commission members shall be approved by the Municipal Assembly by a majority of votes of the members who are present and voting.</p> <p>4. The decision of the Municipal Assembly on the establishment of the Appeal Commission shall contain the duties, responsibilities and other matters considered important for the work of the Appeal Commission.</p> <p>5. The municipal administration shall provide support to the Appeal Commission upon their request.</p> <p>6. The mandate of the Appeal Commission shall be two (2) years within the mandate of the Municipal Assembly.</p>	<p>3. Odluka o imenovanju i razrešenju članova Komisije usvaja se u Skupštini opštine većinom glasova prisutnih članova koji glasaju.</p> <p>4. Odluka skupštine opštine o osnivanju Komisije za žalbe treba da sadrži zadatke, odgovornosti i druga pitanja koja se smatraju važnim za rad Komisije za žalbe.</p> <p>5. Opštinska administracija pruža podršku Komisiji za žalbe na njen zahtev.</p> <p>6. Mandat Komisije za žalbe je dve (2) godine u okviru mandata Skupštine opštine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Përgjegjësitë e komisionit vlerësues</p> <p>1. Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës është përgjegjës:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 Të sigurojë që konkursi i hapur të mbahet në përputhje me procedurat e kësaj Rregullore;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 Të sigurojë që dokumentet të janë në dispozicion për pjesëmarrësit në konkurrim;</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Responsibilities of the Evaluation Commission</p> <p>1. The Evaluation Commission for the allocation of long-term use of immovable property of the municipality is responsible to:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 Ensure that the open competition is conducted in accordance with the procedures of this Regulation;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 Ensure that documents are available to participants in the competition;</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Odgovornosti Komisije za procenu</p> <p>1. Komisija za procenu o davanju na dugoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine odgovorna je:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1 da obezbedi da je otvoreni konkurs održan u skladu sa procedurama ove uredbe;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2 da obezbedi da dokumenti budu dostupni učesnicima u konkursu;</p>

<p>1.3 Të sigurojë që konkursi është shpallur në web-faqen e komunës dhe tabelën e komunës për shpallje publike,;</p> <p>1.4 Të sigurojë konfidencialitet për personat ose subjektet që marrin pjesë në konkurrim.</p> <p>2. Komisioni kërkon nga kryetari i komunës, anulimin e konkursit nëse nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë rregullore.</p>	<p>1.3 Ensure that call for competition is published on the municipal official website and municipality's announcements table;</p> <p>1.4 Ensure confidentiality to persons or entities participating in the competition.</p> <p>2. The commission shall request the mayor to cancel the competition if the conditions set forth in this regulation are not met.</p>	<p>1.3 da obezbedi da je konkurs objavljen na veb sajtu opštine i opštinskoj oglasnoj tabli;</p> <p>1.4 da obezbedi poverljivost za lica ili subjekte koji učestvuju u konkursu.</p> <p>2. Komisija zahteva od gradonačelnika opštine da otkáže konkurs ako nisu ispunjeni svi uslovi utvrđeni ovom uredbom.</p>
<p>Neni 20 Kriteret për zgjedhjen e ofertave</p>	<p>Article 20 Criteria for Selection of Bids</p>	<p>Član 20 Kriterijumi za izbor ponuda</p>
<p>1. Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret vijuese:</p> <p>1.1 Oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë:</p> <p>1.1.1 Vlera e investimit;</p> <p>1.1.2 Numri i të punësuarve nga investimi;</p> <p>1.1.3 Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën;</p>	<p>1. The selection of a bid for allocation of long-term use of immovable property of the municipality shall be based on the following criteria:</p> <p>1.1 Most economically advantageous bid, which shall include:</p> <p>1.1.1 Investment value;</p> <p>1.1.2 Number of employees from investment;</p> <p>1.1.3 Type of investment that is of public interest with priority for the municipality;</p>	<p>1. Izbor ponuda o davanju dugoročne opštinske nepokretne imovine, zasniva se na sledeće kriterijume:</p> <p>1.1 Ekonomski povoljnija ponuda koja uključuje:</p> <p>1.1.1 vrednost ulaganja;</p> <p>1.1.2 broj zaposlenih od ulaganja;</p> <p>1.1.3 vrsta ulaganja koja je od javnog interesa sa prioritetom za opštinu;</p>

<p>1.1.4 Përfitimi financiar dhe ekonomik i komunës;</p> <p>1.1.5 Krite të tjera të cilat mund të përcaktohen me konkurs.</p> <p style="text-align: center;">Neni 21 Procedura për vlerësimin e ofertave</p> <p>1. Kryesuesi i komisionit vlerësues i përcaktuar në nenin 17 të kësaj rregullore, brenda tre (3) dite pune pas mbylljes së njoftimit publik, fton komisionin për hapjen dhe vlerësimin e ofertave. Hapja e ofertave bëhet në kohën dhe vendin e shpallur në njoftimin publik.</p> <p>2. Kryesuesi i komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bënë hapjen e ofertave, ku identifikohen të gjitha çmimet e ofertuesve. Komisioni mban procesverbal i cili nënshkruhet nga anëtarët e komisionit dhe ofertuesit e pranishëm në hapjen e ofertave.</p> <p>3. Pas vlerësimit të ofertave në shprehjen e interesit, Komisioni vlerësues harton raportin përfundimtar dhe përzgjedh ofertën më të favorshme.</p>	<p>1.1.4 Financial and economic benefit of the municipality;</p> <p>1.1.5 Other criteria that may be established by competition.</p> <p style="text-align: center;">Article 21 Bids Evaluation Procedure</p> <p>1. The Chairperson of the Evaluation Commission, defined under Article 17 of this Regulation, within three (3) business days after the public announcement is closed, shall invite the Commission to open and evaluate the bids. Bids shall be opened at the time and place announced in the public announcement.</p> <p>2. The Chairperson of the Commission, after verifying that there is no conflict of interest for him and the members of the Commission, in the presence of the bidders, opens the bids, identifying all the bidders' prices. The Commission shall keep minutes which shall be signed by the members of the Commission and the bidders present at the opening of bids.</p> <p>3. After evaluating the bids of the expression of interest, the Evaluation Commission prepares the final report and selects the most favourable bid.</p>	<p>1.1.4 finansijska i ekonomska korist opštine;</p> <p>1.1.5 ostali kriterijumi koji se mogu odrediti konkursom.</p> <p style="text-align: center;">Član 21 Procedura za procenu ponuda</p> <p>1. Predsedavajući komisije za procenu odrđen u članu 17 ove uredbe, u roku od tri (3) radna dana nakon zatvaranja javnog obaveštenja, poziva komisiju za otvaranje i procenu ponuda. Otvaranje ponuda se obavlja na mestu i vremenu objavljenom u javnom obaveštenju.</p> <p>2. Predsedavajući komisije, nakon provere da ne postoji sukob interesa njega i članova komisija, u prisustvu ponuđača, otvara ponude gde se identifikuju sve cene ponuđača. Komisija vodi zapisnik koji se potpisuje od strane članova komisije i ponuđača prisutnih na otvaranju ponuda.</p> <p>3. Nakon procene ponuda u iskazivanju interesa, Komisija za procenu izradiće završni izveštaj i bira najpogodniju ponudu.</p>
---	---	---

<p>4. Njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike dhe në web-faqen zyrtare të komunës. Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në komisionin e ankesave të përcaktuar më nën 18 të kësaj rregullore, brenda afatit prej shtatë (7) ditë.</p> <p>5. Komisioni i ankesave shqyrton ankesat brenda dhjetë (10) ditësh dhe nëse konstaton se ka pas shkelje gjatë procesit të vlerësimit, kërkon rishqyrtimin e ofertave.</p> <p>6. Nëse komisioni i ankesave vlerëson ankesat si të pabazuara, raporti i vlerësimit së bashku me ofertën e përzgjedhur i dërgohet kuvendit të komunës për miratim, së bashku me:</p> <p>6.1 Një kopje të shpalljes së njoftimit për shprehje të interesit;</p> <p>6.2 Procesverbalin e hapjes së ofertave dhe raportin për vlerësimin e ofertave;</p> <p>6.3 Rekomandimin e Komisionit për përzgjedhjen e fituesit;</p> <p>6.4 Një kopje të protokolluar të ofertës së përzgjedhur; dhe</p> <p>6.5 Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në shprehjen e interesit.</p>	<p>4. The information of the selected bid is delivered to the winner and posted in the public announcements table and on the municipal official website. The parties unsatisfied have the right to appeal within seven (7) days, as defined under Article 18 of this Regulation to the Appeals Committee.</p> <p>5. The Appeal Commission shall review the appeals within ten (10) days and, if it finds that there has been a violation during the evaluation process, shall request a review of the bids.</p> <p>6. If the Appeal Commission finds the appeals as unfounded, the evaluation report and the selected bid shall be sent to the Municipal Assembly for approval, along with:</p> <p>6.1 A copy of the announcement for the expression of interest;</p> <p>6.2 Minutes of opening bids and bids evaluation report;</p> <p>6.3 Recommendation of the Commission regarding the Selection of Winners;</p> <p>6.4 A registered copy of the selected bids; and</p> <p>6.5 Appeals submitted by participants in the expression of interest.</p>	<p>4. Obaveštenje o izabranoj ponudi šalje se pobedniku i objavljuje se na oglasnoj tabli za javnost i na zvaničnoj veb stranici opštine. Nezasadovaljne strane imaju pravo na žalbu u žalbenoj komisiji određenoj u članu 18 ove uredbe u roku od sedam (7) dana.</p> <p>5. Komisija za žalbe će razmotriti žalbe u roku od 10 (deset) dana i ako utvrdi da je bilo povreda tokom procesa procene, zahtevaće ponovno razmatranje ponuda.</p> <p>6. Ukoliko Komisija za žalbe proceni žalbe kao neosnovane, izveštaj procene zajedno sa odabranom ponudom šalje se gradonačelniku zajedno sa:</p> <p>6.1 Kopijom objave obaveštenja za iskazivanje interesa;</p> <p>6.2 Zapisnikom otvaranja ponuda i izveštajem za procenu ponuda;</p> <p>6.3 Preporukom Komisije za izbor dobitnika;</p> <p>6.4 Kopijom protokola odabrane ponude; i</p> <p>6.5 Žalbom dostavljenom od strane učesnika u iskazivanju interesa.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;">Neni 22 Shqyrtimi dhe miratimi i ofertës së rekomanduar në kuvendin e komunës</p> <p>1. Kuvendi i komunës, pas shqyrtimit të raportit të komisionit dhe ofertës së rekomanduar nga komisioni, miraton me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë vendimin përfundimtar për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë.</p> <p>2. Nëse kuvendi miraton vendimin përfundimtar, atëherë autorizon kryetarin e komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratën më fituesin.</p> <p>3. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nënshkruhet nga kryetari i komunës i cili përfaqëson komunën dhe nga fituesi i përzgjedhur, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.</p>	<p style="text-align: center;">Article 22 Review and Approval of the recommended bid in the Municipal Assembly</p> <p>1. The Municipal Assembly, after reviewing the report of the Commission and the bid recommended by the Commission, by a majority of votes of present members and voting, shall approve the final decision on allocation for long-term use of immovable property of the municipality.</p> <p>2. If the Assembly approves the final decision, the latter authorizes the Mayor to enter into a contract with the winner, within ten (10) business days of the entry into force of the decision.</p> <p>3. The contract for allocation for long-term use of immovable property of the municipality shall be signed by the mayor as representative of the municipality and by the selected winner, whereby the rights and obligations of the contracting parties are determined.</p>	<p style="text-align: center;">Član 22 Razmatranje i odobrenje preporučene ponude u Skupštini opštine</p> <p>1. Skupština opštine, nakon razmatranja izveštaja komisije i preporučene ponude komisije, usvaja većinom glasova prisutnih i članova i onih koji glasaju konačnu odluku za davanje opštinske nepokretne imovine na dugoročno korišćenje.</p> <p>2. Ukoliko Skupština usvoji konačnu odluku, ovlašćuje gradonačelnika da u roku od deset (10) radnih dana od stupanja na snagu ove odluke zaključi ugovor sa dobitnikom.</p> <p>3. Ugovor o davanju na dugoročno korišćenje opštinske nepokretne imovine potpisuće se od strane gradonačelnika koji predstavlja opštinu i odabranog dobitnika, kojim će se utvrditi prava i obaveze ugovornih strana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 23 Negocimi i ofertave nga Kryetari i Komunës</p> <p>1. Personat fizik dhe juridik mund të shprehin interes për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës te Kryetari i Komunës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 23 Negotiation of bids by Mayor</p> <p>1. Natural and legal persons may express interest in acquiring for use of the municipality property to the Mayor.</p>	<p style="text-align: center;">Član 23 Pregovaranje ponuda od strane gradonačelnika</p> <p>1. Fizička i pravna lica mogu izraziti interesovanje za uzimanje na korišćenje opštinske imovine kod gradonačelnika opštine.</p>

<p>2. Të drejtën e negocimit Kryetari i Komunës mund ta shfrytëzoj në rastet kur vlera e investimit është së paku 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës të vitit paraprak, por jo më shumë se vlera minimale e përcaktuar me Ligjin për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës sipas sektorëve në vijim:</p> <p>2.1 Në sektorët, Energji me infrastrukturë dhe miniera; Transport dhe telekomunikacion dhe Shëndetësi, vlera e investimit duhet të jetë minimum 10% e investimeve kapitale, por jo më shumë së 30 milion.</p> <p>2.2 Në sektorët, Turizëm dhe Industri përpunuese, vlera e investimit duhet të jetë minimum 10% e investimeve kapitale, por jo më shumë së 20 milion.</p> <p>2.3 Në sektorët, Bujqësi dhe industri ushqimore, Parqe industriale dhe teknologjike; dhe Administrim i ujërave të zeza dhe mbeturinave, vlera e investimit duhet të jetë minimum 10% e investimeve kapitale, por jo më shumë së 10 milion.</p> <p>3. Në rast kur vlera e investimeve, tejkalon vlerën e përcaktuar për sektor, në paragrafin 2, atëherë projekti fiton Statusin e investimit strategjik dhe</p>	<p>2. A Mayor may exercise their right of negotiation in the cases when the value of the investment is at least 10% of the municipality's total capital investing value is at least ten percent (10%) of the overall budget for municipal capital investment of the previous year, but not more than the minimum value defined by the Law on Strategic Investments in the Republic of Kosovo, and according to the following sectors:</p> <p>2.1 In sectors such as Energy, Infrastructure and Mining; Transport & Telecommunications and Health, the investing value should be at least ten percent (10%) capital investments, but not more than 30 million.</p> <p>2.2 In the sectors of Tourism and Processing Industry, the investing value shall be at least 10% of capital investments, but not more than 20 million.</p> <p>2.3 In sectors of Agriculture and Food Industry, Industrial and Technological Parks; and Wastewater and Waste Management, the investing value shall be a minimum of 10% of capital investments, but not exceeding 10 million.</p> <p>3. Where the investing value exceeds the value set per sector in paragraph 2, then the project shall obtain the strategic investment status and</p>	<p>2. Pravo na pregovore gradonačelnik opštine može da iskoristiti u slučajevima kada vrednost ulaganja iznosi najmanje 10% ukupnog budžeta za kapitalna ulaganja opštine prethodne godine, ali ne više od minimalne određene vrednosti Zakonom o strateškim ulaganjima u Republici Kosovo prema sledećim sektorima:</p> <p>2.1 U sektorima, Energetike sa infrastrukturuom i rudarstvom; Transport i telekomunikacije i zdravstvo, vrednost ulaganja trebala bi da bude minimalno 10% kapitalnih ulaganja, ali ne više od 30 miliona.</p> <p>2.2 U sektorima, Turizam i proizvodna industrija, vrednost investicije treba da bude minimalno 10% kapitalnih ulaganja, ali ne više od 20 miliona.</p> <p>2.3 U sektorima, poljoprivreda i prehrambena industrija, industrijski i tehnološki parkovi; i upravljanje otpadnih voda i otpadom, vrednost ulaganja treba da bude minimalno 10% kapitalnih ulaganja, ali ne više od 10 miliona.</p> <p>3. U slučaju ako vrednost ulaganja prelazi utvrđenu vrednost po sektoru, u stavu 2., tada projekat dobija Status strateškog ulaganja i</p>
--	---	--

<p>trajtohet sipas ligjit përkatës për investime strategjike.</p> <p>4. Të drejtën e negocimit Kryetari i Komunës mund ta shfrytëzoj në rastet kur kurë një investitor ka shprehur interesim për hapjen e një biznesi në interes të komunës, si:</p> <p>4.1 Investimet në sektorin e prodhimit; 4.2 Industri përpunuese; 4.3 Industri ushqimore; 4.4 Parqe industriale dhe teknologjike.</p> <p>5. Të drejtën e negocimit Kryetari i Komunës mund ta shfrytëzoj në rastet kur nuk ka interesim për marrjen e pronës së komunës në shfrytëzim nga palët për së paku tre (3) vitet e fundit, me kusht që:</p> <p>5.1 Prona të jetë në listën e publikuar të pronave për dhënie në shfrytëzim për 3 vite me radhë; dhe</p> <p>5.2 Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur interesim për marrjen e kësaj prone në shfrytëzim.</p> <p>6. Pas negocimit të ofertës, kryetari i komunës i propozon kuvendit të komunës të miratoj vendimin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke i bashkangjitur dokumentet përcjellëse, si:</p>	<p>is treated under the relevant law on Strategic Investments.</p> <p>4. A Mayor may exercise his or her right of negotiation in cases when an investor has expressed his interest in starting a business that serves the interest of the municipality, such as:</p> <p>4.1 Investment in the Manufacturing Sector; 4.2 Processing Industry; 4.3 Food Industry; 4.4 Industrial and Technological Parks.</p> <p>5. A Mayor may exercise their right of negotiation in cases where there is no interest in acquiring the municipal property for use by parties for at least the last three (3) years, provided that:</p> <p>5.1 Property be on the published list of properties to be allocated for use for 3 consecutive years; and</p> <p>5.2 During this period there was no interest in acquiring this property for use.</p> <p>6. After negotiating the bid, the Mayor of the Municipality proposes to the Municipal Assembly the approval of the decision on allocation for use of the municipal immovable property, while attaching the supporting documents such as:</p>	<p>tretira se u skladu sa relevantnim zakonom o strateškim ulaganjima.</p> <p>4. Gradonačelnik opštine može iskoristiti pravo pregovora u slučajevima kada je ulagač izrazio interes za pokretanje biznisa u interesu opštine, kao što su:</p> <p>4.1 ulaganja u proizvodni sektor; 4.2 prerađivačka industrija; 4.3 prehrambena industrija; 4.4 industrijski i tehnološki parkovi.</p> <p>5. Gradonačelnik opštine može da ostvari pravo na pregovore u slučajevima kada ne postoji interes za uzimanjem opštinske imovine na korišćenje od strane stranaka najmanje poslednje tri (3) godine, pod uslovom da:</p> <p>5.1 Imovina treba da bude na objavljenj listi imovina za davanje na korišćenje na 3 godine uzastopno; i</p> <p>5.2 Tokom ovog periodu nije bilo interesovanja za uzimanje ove imovine na korišćenje.</p> <p>6. Nakon pregovora o ponudi, gradonačelnik predlaže Skupštini opštine da odobri odluku o davanju na korišćenje nepokretne imovine opštine, priložeći sledeća dokumenta, kao što su:</p>
--	--	--

<p>6.1 Kërkesën e paraqitur nga palët e interesuara për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;</p> <p>6.2 Ofertën e negociuar, për dhënien në shfrytëzim ta pronës se paluajtshme të komunës;</p> <p>6.3 Propozim-Vendimi nga kryetari i komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim duke përcaktuar afatin e dhënies në shfrytëzim;</p> <p>6.4 Projekti i paraqitur nga investitori dhe plani dinamik i realizimit të investimit;</p> <p>6.5 Certifikata e pronësisë dhe kopja e planit të pronës e cila jepet në shfrytëzim;</p> <p>6.6 Certifikatën e regjistrimit të biznesit, vërtetim që nuk ka obligime tatimore, qarkullimi bankar për vitin paraprak.</p> <p>7. Kuvendi i komunës me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë, miraton vendimin për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim sipas negocimit të ofertave nga kryetari i komunës.</p>	<p>6.1 The request submitted by the interested parties on the allocation for use of the municipal immovable property;</p> <p>6.2 The negotiated bid, on allocation for use of the municipal immovable property;</p> <p>6.3 Proposed-decision from the Mayor of the Municipality on the allocation for use of the municipal property while specifying the deadline for giving it for use;</p> <p>6.4 The project presented by the investor and the dynamic plan for implementing the investment;</p> <p>6.5 Ownership certificate and a copy of property plan which is given for use;</p> <p>6.6 Business registration certificate, a proof that it has no tax liabilities, bank turnover for the previous year.</p> <p>7. The Municipal Assembly by a majority votes of the members present and voting, adopts the decision on allocation for use of the municipal immovable property according to the bid negotiation by the Mayor of the Municipality.</p>	<p>6.1 Zahtev koji su podneli zainteresovane strane za uzimanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine;</p> <p>6.2 Dogovorena ponuda za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine;</p> <p>6.3 Predlog - Odluka gradonačelnika o davanju na korišćenje opštinske imovine koja definiše rok za davanje na korišćenje;</p> <p>6.4 Projekat predstavljen od strane investitora i dinamički plan realizacije ulaganja;</p> <p>6.5 Potvrdu o vlasništvu i kopiju imovinskog plana koji se izdaje na korišćenje;</p> <p>6.6 Potvrda o registraciji preduzeća, potvrda kao dokaz da nema poreske obaveze, bankarski promet za prethodnu godinu.</p> <p>7. Skupština opštine većinom glasova prisutnih i koji glasaju, odobrava odluku za davanje opštinske nepokretne imovine na korišćenje prema dogovorenim ponudama od strane gradonačelnika.</p>
--	--	---

<p align="center">Neni 24</p> <p align="center">Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta</p>	<p align="center">Article 24</p> <p align="center">Allocation for use of immovable property of the municipality for special cases</p>	<p align="center">Član 24</p> <p align="center">Davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine za posebne slućajeve</p>
<p>1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për raste të veçanta jepet pa zbatuar procedurat e konkurrimit. Përjashtimi i procedurave të rregullta të konkurrimit bëhet për interes të përgjithshëm publik.</p> <p>2. Procedurat e konkurrimit nuk zbatohen për këto raste kur kërkesa për dhënien në shfrytëzim bëhet nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Kërkesa duhet të jetë e adresuar nga titullari-udhëheqësi i institucionit përkatës qendrorë si dhe duhet të përcaktohet qëllimi dhe interesi publik i cili është në harmoni të plotë me dokumentet e planifikimit hapësinor.</p> <p>4. Përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, si dhe institucionet ndërkombëtare që kanë marrëveshje me Republikën e Kosovës, kërkesën për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës pa procedura të konkurrimit duhet ta adresojnë përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme.</p> <p>5. Procedura e konkurrimit nuk zbatohet edhe në rastet kur kërkesa adresohet nga institucionet qendrore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me qëllim të realizimit të</p>	<p>1. Allocation for use of immovable property of the municipality for special cases shall be granted without applying the competition procedures. The exclusion of regular competition procedures is done as per the general public interest.</p> <p>2. Competition procedures shall not apply to cases when the request for allocation for use is made by central institutions of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. The request shall be addressed by the Head-leader of the relevant institution and it should determine the purpose and public interest which is in full concordance with spatial planning documents.</p> <p>4. Diplomatic and consular representations, and international institutions which have agreements with the Republic of Kosovo, shall address the request for allocation for use of immovable property of the municipality without competition procedures through the Ministry of Foreign Affairs.</p> <p>5. The competition procedure does not apply as well where the request for use of municipal immovable property is addressed by central institutions for the purpose of making</p>	<p>1. Davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine za posebne slućajeve odobrava se bez sprovođenja procedura konkurisanja. Iskljućivanje redovnih postupaka konkurisanja se vrši za opšti javni interes.</p> <p>2. Postupci konkurisanja se ne sprovode u ovim slućajevima kada zahtev za davanjem na korišćenje podnosi centralna institucija Republike Kosova.</p> <p>3. Zahtev se treba uputiti od strane titulara - rukovodioca odgovarajuće centralne institucije kao i treba navesti svrhu i javni interes koji je u potpunosti u skladu sa dokumentima prostornog planiranja.</p> <p>4. Diplomatska i konzularna predstavništva, kao i međunarodne institucije koje imaju sporazume sa Republikom Kosova, trebalo bi da podnesu zahtev za uzimanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine bez procedura konkurisanja preko Ministarstva inostranih poslova.</p> <p>5. Procedura konkurisanja se ne sprovodi čak i kada se zahtev upućuje od strane centralnih institucija za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine u svrhu realizacije</p>

<p>investimeve në sektorin e prodhimit të energjisë së ripërtrishme.</p> <p>6. Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim për raste të veçanta, bëhet konform kërkesës me shkrim nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, si:</p> <p>6.1 Presidenti; 6.2 Kuvendi i Kosovës; 6.3 Kryeministri/Qeveria; 6.4 Ministri/Ministria; 6.5 Kryetari i Këshillit Gjyqësor dhe Kryetari i Këshillit Prokurorial i Kosovës; 6.6 Kryeshefi i një Agjencie të Pavarura Shtetërore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Shqyrtimi i kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta</p> <p>1. Kryetari i komunës, pas pranimit të kërkesës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për rastet e veçanta, kërkesën e adreson tek kuvendi i komunës për shqyrtim dhe miratim, së bashku me materialet përcjellëse si:</p> <p>1.1 Kërkesën zyrtare të institucionit përkatës;</p>	<p>investments in the sector of renewable energy production.</p> <p>6. Allocation for use of immovable property of the municipality for special cases shall be based on a written request from the central institutions of the Republic of Kosovo, such as:</p> <p>6.1 The President; 6.2 The Assembly of Kosovo; 6.3 The Prime Minister/Government; 6.4 A Minister/Ministry; 6.5 The Chairperson of Judicial Council and the Chairperson of the Kosovo Prosecutorial Council; 6.6 Executive Chief of an Independent State Agency.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 Review of the request for allocation for use of immovable property of the municipality for special cases</p> <p>1. The Mayor, after receiving the request for allocation for use of immovable property of the municipality in special cases, shall address the request to the Municipal Assembly for review and approval, along with supporting materials such as:</p> <p>1.1 Official request of the institution concerned;</p>	<p>investicija u sektoru proizvodnje obnovljive energije.</p> <p>6. Davanje opštinske nepokretne imovine na korišćenje za posebne slučajeve će biti u skladu sa pismenim zahtevom od strane centralnih institucija Republike Kosova, kao što su:</p> <p>6.1 Predsednik; 6.2 Skupština Kosova; 6.3 Premijer/Vlada; 6.4 Ministar/Ministarstvo; 6.5 Predsednik sudskog saveta i Predsednik Tužilačkog saveta Kosova; 6.6 Izvršni šef Nezavisne državne agencije.</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Razmatranje zahteva za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine za posebne slučajeve</p> <p>1. Gradonačelnik opštine, nakon što je primio zahtev za davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine za posebne slučajeve, upućuje zahtev opštinskoj skupštini na razmatranje i odobrenje, zajedno sa pratećim materijalima kao što su:</p> <p>1.1 Službeni zahtev relevantnoj instituciji;</p>
--	---	--

<p>1.2 Arsyetimin e interesit të përgjithshëm publik.</p> <p>2. Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës me shumicën e votave të anëtarëve prezent dhe që votojnë merr vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për raste të veçanta.</p> <p>3. Vendimi i kuvendit të komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për raste të veçanta përmban:</p> <p>3.1 Emrin e institucionit të cilit i jepet në shfrytëzim prona e paluajtshme e komunës;</p> <p>3.2 Emrin, përshkrimin dhe lokacionin e pronës që jepet në shfrytëzim;</p> <p>3.3 Nëse dhënia në shfrytëzim do të bëhet me kompensim ose pa kompensim, si dhe për mënyrën e kompensimit;</p> <p>3.4 Afatin e dhënies në shfrytëzim;</p> <p>3.5 Qëllimin për të cilin jepet në shfrytëzim, dhe</p> <p>3.6 Çështje të tjera të cilat mund të përcaktohen nga kuvendi i komunës.</p>	<p>1.2 Justification of general public interest.</p> <p>2. The Municipal Assembly, after reviewing the request by a majority of votes of the members who are present and voting, shall decide on the allocation for use of immovable property of the municipality for special cases.</p> <p>3. The decision of the Municipal Assembly on allocation for use of immovable property of the municipality for special cases shall include:</p> <p>3.1 Name of the institution to which is allocated for use the immovable property of the municipal;</p> <p>3.2 Name, description and location of the property being allocated for use;</p> <p>3.3 Whether the allocation will be made with compensation or without compensation, and the method of compensation;</p> <p>3.4 Period of allocation for use;</p> <p>3.5 Purpose of allocation for use, and</p> <p>3.6 Other issues that may be determined by the Municipal Assembly.</p>	<p>1.2 Obrazloženje opšteg javnog interesa.</p> <p>2. Skupština opštine, nakon razmatranja zahteva većinom glasova prisutnih članova i glasa, odlučuje o korišćenju opštinske nepokretne imovine za posebne prilike.</p> <p>3. Odluka Skupštine opštine o davanju na korišćenje opštinske imovine, za posebne slučajeve, sadrži:</p> <p>3.1 Naziv institucije kojoj je data na korišćenje opštinska nepokretna imovina;</p> <p>3.2 Naziv, opis i lokaciju nekretnine koja se daje na korišćenje;</p> <p>3.3 Ako se davanje na korišćenje izvršiti uz nadoknadu ili bez naknade, i o načinu nadoknade;</p> <p>3.4 Rok davanja na korišćenje;</p> <p>3.5 Namena zbog čega se daje na korišćenje, i</p> <p>3.6 Ostala pitanja koja se mogu utvrditi od strane Skupština opštine.</p>
---	--	---

<p>4. Kuvendi me vendim autorizon kryetarin e komunës, të lidhë kontratë më përfaqësuesin e institucionit qendror i cili ka paraqitur kërkesën.</p> <p>5. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për raste të veçanta evidentohet në librat kadastrale të komunës.</p> <p>6. Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim më qëllim të realizimit të investimeve në sektorin e energjisë, bëhet me vendim të kuvendit të komunës, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm dhe nuk mund të jepet pa kompensim.</p>	<p>4. The Assembly, by decision, authorizes the Mayor to enter into a contract with the representative of the central institution submitting the request.</p> <p>5. Allocation for use of immovable property of the municipality for special cases is recorded in the cadastral books of the municipality.</p> <p>6. Allocation for use of immovable property of the municipality for the purpose of making investments in the energy sector shall be done by decision of the Municipal Assembly is based on the applicable legislation and shall not be granted without compensation.</p>	<p>4. Skupština odlukom ovlašćuje gradonačelnika opštine da zaključi ugovor sa predstavnikom centralne institucije koji je podneo zahtev.</p> <p>5. Davanje na korišćenje opštinske nepokretne imovine za posebne slučajeve evidentirano je u katastarskim knjigama opštine.</p> <p>6. Davanje opštinske nepokretne imovine na korišćenje u svrhu realizacije investiranja u energetskom sektoru, vrši se odlukom Skupštine opštine na osnovu važećeg zakonodavstva i ne može se dati bez naknade.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Shfrytëzimi i pronës së paluajtshme të komunës për nevojat e komunës</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Use of immovable property of the municipality for municipal needs</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Korišćenje opštinske nepokretne imovine za opštinske potrebe</p>
<p>1. Komuna ka të drejtë të jep pronën në shfrytëzim, për institucionet sajë vartëse apo të bëjë destinimin e pronës për nevojat e sajë, pa i zhvilluar procedurat e përcaktuara më ligjin përkatës për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale.</p> <p>2. Institucionet vartëse për të cilat komuna nuk zhvillon procedurën e përcaktuar për dhënien e pronës komunale, janë:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 Ndërmarrjet publike lokale, sipas Ligjit përkatës për ndërmarrjet publike;</p>	<p>1. The municipality is entitled to allocate for use the property to its subordinate institutions or to designate the property for its own needs, without undergoing the procedures set forth in the relevant law on Allocation for Use and Exchange of Municipal Immovable Property.</p> <p>2. The subordinate institutions for which the municipality does not carry out the procedures for allocation of municipal property are:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 Local publicly owned enterprises, in accordance with the relevant Law on Publicly Owned Enterprises;</p>	<p>1. Opština ima pravo da daje imovinu na korišćenje svojim podređenim institucijama ili da odredi imovinu za sopstvene potrebe, bez razvijanja utvrđenih procedura odgovarajućim zakonom o korišćenju i razmeni opštinske imovine.</p> <p>2. Podređene institucije za koje opština ne razvija utvrđenu proceduru za davanje opštinske imovine, su:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1 lokalna javna preduzeća, prema odgovarajućem Zakonu o javnim preduzećima;</p>

<p>2.2 Institucionet shkollore në kompetencë të komunës;</p> <p>2.3 Institucionet shëndetësore në kompetencë të komunës, si dhe</p> <p>2.4 Të gjitha institucionet tjera, në kompetencë të komunës.</p>	<p>2.2 School institutions within the responsibility of the municipality;</p> <p>2.3 Municipal health care institutions, and</p> <p>2.4 All other institutions within responsibility of the municipality.</p>	<p>2.2 školske institucije u nadležnosti opštine;</p> <p>2.3 zdravstvene institucije u nadležnosti opštine, i</p> <p>2.4 sve ostale institucije u nadležnosti opštine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 27 Mbikëqyrja e kontratave</p>	<p style="text-align: center;">Article 27 Supervision of contracts</p>	<p style="text-align: center;">Član 27 Nadzor ugovora</p>
